



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**  
**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /**  
**Ministry of Culture, Youth and Sports**

Kabineti i Ministrimit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 16/2015  
Datë: 18.02.2015

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 ( paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 ( shtatë ) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe u mbështetur në nenin 9 ( paragrafi 23 dhe 31) të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe Rregulloren Nr. 01/2008 mbi Masat e Sigurisë për Trashëgiminë e Luajtshme, më datën 18.02.2015, mori këtë :

**V E N D I M**

1. Lejohet bartja e 8 (tetë) artefakteve për qëllim të ekspozimit të përkohshëm në përputhje me Memorandumin e nënshkruar ndërmjet MKRS/DTK dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Trashëgimi në Ministrinë Franceze të Kulturës dhe Komunikimit.
2. Ekspонатet prezantohen në ekspozitën “Perënditë e Ballkanit” , e cila hapet me 21 mars 2015.
3. Personat përgjegjës për pranimin e ekspozateve në Muzeun e Kosovës janë:  
z. Alian Villes dhe Anabelle Palignac, kurse për sigurinë e tyre është e autorizuar kompania- transportues profesional LP Arts.
4. Këtij Vendimi i bashkëngjitet Lista e ekspozateve me numër të inventarit.

